



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 16.04.2021, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Vardari” me kapacitet të instaluar 1972 kW.
3. Mbi modifikimin e licencës nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011, të bordit të komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të bordit të komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “Kurum Interantional” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec-i “Ulëz” me kapacitet të instaluar 24 MW.
4. Mbi shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a., për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 202 datë, 02.12.2020, për miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”.
5. Mbi fillim e procedurës për shqyrtimin e propozimeve të shoqërisë Operatori Sistemit të Transmetimit sh.a., për disa ndryshime në rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike.
6. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Mars 2021.